




**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**  
**REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE**  
**MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE**



**Ekstrakt nga procesverbali i mbledhjes së nëntë - IX, të rregulltë të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, e mbajtur me datën: 28.09.2020.**

**Prezentë në mbledhje nga anëtarët e Kuvendit të Komunës ishin:** Vjollca Konjusha - Kryesuese e Kuvendit të Komunës, Suhat Ademi - Zëvendës Kryesues i Kuvendit të Komunës për Komunitete, Remzi Shala, Arjeta Jashari, Ilir Hasani, Mirvete Gërguri, Sabit Bullatovci, Miranda Shabani, Albert Jasharaj, Jetmir Berisha, Ali Zogjani, Sabri Rexhepi, Durim Hajra, Doruntina Jashari, Eglantina Azemi, Aida Alimi, Arjana Zogjani, Naser Graiçevci, Migjen Kolshi, Mehdi Lahu, Driton Ademi, Ali Ismaili, Driton Hasolli, Mensur Graiçevci, Shaban Ademi, Hysni Hasani dhe Ljubisha Qirkoviq.

**Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive të Komunës:** Fadil Krasniqi - Nënkryetar i Komunës, Ramadan Jashanica - Drejtor i Drejtorisë për Financa e Buxhet dhe Islam Shabani - Drejtor i Drejtorisë së Arsimit.

**Të tjerë:** Hysen Sllamniku - Zyrtar për Mirëqenie Sociale.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës pasi verifikoi kuorumin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës prezentë në mbledhje, prezantoi pikat e rendit të ditës për shqyrtim në mbledhjen e sotme me këtë:

**REND DITE**

1. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e datës 29.07.2020.
2. Pyetje dhe përgjigje parlamentare.
3. Propozim për shqyrtimin e Buxhetit të Planifikuar të Komunës për vitin 2021.
4. Raporti i Auditimit të Jashtëm për vitin 2019.
5. Raporti i Drejtorisë së Shëndetësisë për menaxhimin e pandemisë Covid - 19, me të dhëna statistikore të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë.
6. Shqyrtimi i dytë i 'Projekt-Rregullores për organizimin e punës së shkollave fillore të mesme të ulëta dhe shkollave të mesme të larta në Fushë-Kosovë.
7. Propozim për fillimin e procedurave për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal.
8. Propozim për fillimin e procedurave për përgatitjen e Raportit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Planin Zhvillimor Komunal.
9. Propozim për rishqyrtimin dhe ndryshimin e vendimit Nr. 47, të datës 02.03.2020, për shpalljen e lokalitetit të Boshtres 'Forysthia europiane' monument i mbrojtur i natyrës në fshatin Harilaç.

10. Propozim për shqyrtimin e raportit të vlerësimit Nr. 020-593/3, të datës 28.02.2020 i vendimit për ndërtimin e Palestrës së Sporteve në zonën turistike, në Ngatrën Kadastrale P-00443-1 në fshatin Sllatinë e Vogël.
11. Informatë për fillimin e vitit të ri shkollor 2020-2021.
12. Të ndryshme.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës lexoi pikat e rendit të ditës së propozuar me pikën shtesë: 'Informatë për fillimin e vitit të ri shkollor 2020-2021' dhe hapi diskutimin.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim për aprovim rendin e ditës me pikën shtesë.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej nëntëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me unanimitet të votave e aprovoi për shqyrtim rendin e ditës së propozuar me pikën shtesë: 'Informatë për fillimin e vitit të ri shkollor 2020-2021'.

#### **Pika e parë (1) - Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e dates 29.07.2020.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës:** E kemi për aprovim 'ekstraktin e procesverbalin nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur me datën 29.07.2020'. Hap diskutimin për vërejtjet dhe sugjerimet tuaja.

**Ali Ismaili:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë e kam një vërejtje në faqën numër shtatë të ekstraktit të procesverbalit lidhur me diskutimin tim. Unë pajtohem me mendimin e kolegut tim z. Driton Ademi, se duhet të ketë harmonizim ndërmjet Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Drejtorisë së Arsimit për ndërtimin e objektit të çerdhes, e jo të humbet donacioni. Po ashtu është fakt se Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë nuk na ka dorëzuar për tre vite të këtij mandati, listën e pronave komunale, andaj ne si asambleistë kemi shumë vështirësi në punën tonë, nuk mund të japim ndonjë propozim konkrete për ndërtimin e objekteve publike, qoftë çerdhe apo shkollë në qytetin tonë. Ne nuk e kemi asnjë informata për pronat e uzurpuara, meqë pronat komunale nuk janë publike në ueb-faqën e komunës, ashtu siç është e definuar me ligj.

Pasi që vërejtje apo sugjerime tjera nuk pati, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim për aprovim 'ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur me datën 29.07.2020' me përmirësimin e cekur me lartë të diskutimit të anëtarit të Kuvendit të Komunës z. Ali Ismaili.

U votua me: trembëdhjetë vota 'për', gjashtë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej nëntëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave e aprovoi 'ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës, e mbajtur me datën 29.07.2020', me përmirësimin e cekur me lartë të diskutimit të anëtarit të Kuvendit të Komunës z. Ali Ismaili.

## **Pika e dytë (2) - Pyetje dhe përgjigje parlamentare.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës:** E kemi pikën 'Pyetje dhe përgjigje parlamentare', ftoi anëtarët e Kuvendit të Komunës që të parashtrojnë pyetje për Ekzekutivin e Komunës.

**Aida Alimi:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë e kam një pyetje për Drejtorinë e Administratës, kur do të jenë funksional mikrofonat në sallën e Kuvendit? Plani i Punës së Kuvendit të Komunës nuk po zbatohet e nderuara znj. Kryesuese e Kuvendit të Komunës, shumë pika nuk janë trajtuar fare deri tani. Unë vetë jam anëtare në Komisionin për emërtimin e rrugëve, kemi shumë kërkesa nga qytetarët për emërtimin e rrugëve të reja, andaj ky komision, duhet t'i shqyrton ato kërkesa, të emërton rrugët e reja dhe të bënë ndryshimin e emërtimeve të disa rrugëve ekzistuese në qytetin e Fushë-Kosovës. Pyetja ime e fundit është një kërkesë e banorëve të fshatit Miradi e Poshtme, ku nga era e lumit, ku hidhen produktet e qumështit, qytetarët nuk mund ta përballojnë erën e rëndë, kjo çështje paraqet një shqetësim, andaj për çdo hap të ndërmarrë nga Inspektorati dhe Komuna jonë kërkojmë që të informohemi.

**Driton Hasolli:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë bashkëngjitem me kërkesën dhe shqetësimin e ngritur në Kuvendin e Komunës, nga të gjitha partitë politike për rregullimin e mikrofonave në sallën e Kuvendit. Ne kërkojmë nga ju znj. Kryesuese e Kuvendit të Komunës, të jeni në nivelin e përgjegjësisë dhe deri në mbledhjen e ardhshme ta rregulloni këtë çështje, që po na përcjellë më shumë se dy vite.

**Durim Hajra:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Në Kuvendin e Komunës në fillim të vitit 2020, është marrë vendimi për blerjen e fazanëve dhe lepujëve të egër, për këtë punë është ndarë shuma e mjeteve financiare prej 15,000.00€, unë pyes çka ka ndodhur me këtë projekt në bujqësi, apo kjo punë do të bartet prapë në buxhetin e vitit 2021? Lidhur me caktimin e Zëvendës Drejtoreshës në shkollën 'Selman Riza' në Fushë-Kosovë, çka ka ndodhur, caktimi në këtë pozitë është bërë pa konkurs publik, unë pyes cila është kontrata e punës, a është vazhduar ajo kontratë për zonjën në fjalë?

**Mehdi Lahu:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë e kërkoi një sqarim nga Drejtori për Arsim lidhur me nxënësit që duhet ta mbajnë mësimin e kombinuar, një javë në shkollë dhe një javë online sipas planit të paraparë B, por për këta nxënës nuk po mbahet mësimi sipas planit, as në shkollë dhe as online.

**Shaban Ademi:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë e kam një pyetje për Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, por meqë drejtori mungon me arsye shëndetësore, po ju drejtohem juve i nderuari z. Nënkyetar i Komunës, ne jemi këtu katër asambleistë nga fshati Henc, por për zgjidhjen e problemeve jetike nuk po kemi autoritet sa duhet asnjëri, problemet ne po i ngritim këtu në Kuvendin e Komunës, por zgjidhje për qytetarët nuk po ofrohen nga Ekzekutivi i Komunës. Ujërat e zeza nga rrjeti i kanalizimit, po dalin rrugëve, kundërmon erë e rëndë e padurueshme. Unë e kam pyetur Drejtorin z. Maliq Berisha, përgjegjëja e tij e sinqertë ka qenë, se tani nuk kemi kontratë me Kompaninë. Unë kërkoi nga Ekzekutivi i Komunës që kjo punë të trajtohet seriozisht, nuk durohet era një vitë, i nderuari Nënkyetar i Komunës, diçka duhet të ndërmirret në këtë drejtim, kjo është epidemi për banorët e fshatit Henc.

**Nënkryetari i Komunës:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Këtë çështje do ta rregullojmë në momentin e lidhjes së kontratës me një Kompani për mirëmbajtjen e rrjeteve të kanalizimeve dhe rrugëve. Kjo punë është detyrë e Kompanisë së Ujësjetës Rajonal Prishtina, ne do t'i kontaktojmë ata dhe do të bëjmë përpjekje për zgjidhjen e këtij problemi.

**Ali Ismaili:** Ne e kemi marrë materialin për mbledhjen e Kuvendit të Komunës në mënyrën elektronike me kohë, në email adresat tona zyrtare, por kërkojmë që ta kemi edhe të printuar në tavolinat tona si material fizik.

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës:** Të nderuar/a anëtarë të Kuvendit të Komunës, përveç marrjes së materialit në mënyrë elektronike shtatë ditë para mbledhjes, ju edhe materialin fizik do ta keni të gatshëm tre ditë para mbledhjes së Kuvendit të Komunës, apo edhe më herët në kontakt me personelin administrativ, andaj secili mund të vini dhe ta merrni në Shërbimin e Kuvendit të Komunës.

**Drejtori për Arsim:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Lidhur me pyetjen e parashtruar nga anëtari i Kuvendit të Komunës z. Durim Hajra për Zëvendës Drejtoreshën në shkollën 'Selman Riza' në Fushë-Kosovë, ju informoi se është në kompetencën e Kryetarit të Komunës, që ta cakton për një kohë të përkohshme, qoftë drejtorin, qoftë zëvendës drejtorin e një shkollë, deri në kryerjen e procedurave sipas konkursit publik. Viti i ri shkollor 2020-2021 ka filluar me datën 14.09.2020, klasët për parashkollorë dhe klasët prej një deri në klasën e gjashtë kanë filluar javën e parë, ndërsa klasët prej shtatë, tetë dhe nëntë kanë filluar më vonë, e kemi bërë edhe ndarjen e klasave në dy ndërrime për një mësimdhënës, sepse në qytet, në shkollën 'Mihal Grameno' kemi numër të madh të nxënësve, ndërsa në fshatra punon e tërë klasa bashkë, sepse numri i nxënësve është më i vogël. Kemi punuar shumë për mbarëvajtjen e mësimit edhe në drejtimet e shkollave të mesme. Sqaroi se klasa e shtatë, tetë dhe nëntë, në shkollën 'Mihal Grameno' në Fushë-Kosovë, janë duke e zhvilluar mësimin e kombinuar sipas programit 'B' të mësimit, një javë në shkollë dhe një javë online. Në këtë shkollë i kemi 45 nxënës në një paralele, ata i kemi ndarë në dy grupe për secilin mësimdhënës, nga njëzet e dy nxënës në grup. Ju duhet ta dini se shkolla 'Mihal Grameno' në Fushë-Kosovë kërkon një menaxhim dinamikë të organizimit dhe mësimit, që sigurisht na duhet ta ndryshojmë varësisht nga rrjedha e situatës me pandeminë Covid - 19.

**Nënkryetari i Komunës:** Lidhur me pyetjen e parashtruar nga anëtarja e Kuvendit të Komunës znj. Aida Alimi, këtë punë do ta rregullon Drejtoria e Administratës. Nëse një plan i punës rezlizohet 60-70%, është në rregull, pikat e përealizuara do të analizohen dhe shqyrtohen. Në Komisionin për emërtimin e rrugëve, ju jeni vetë aty, duhet ta merrni vetë iniciativën, të punoni me grupin e punës dhe t'i zgjidhni kërkesat e qytetarëve për emërtimin e rrugëve. Lidhur me shqetësimin për erën e rëndë gjatë verës në fshatin Miradi e Poshtme, ky problem po rrjedhë nga Komuna e Graçanicës, ne shpresojmë që në bashkëpunim me ta dhe Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal do ta zgjidhim. Pyetja e anëtarit të Kuvendit të Komunës z. Durim Hajra, lidhur me blerjen e fazanëve dhe lepujve të egër në natyrë, ka patur përpjekje për realizimin e këtij projekti të ri, por kjo deri tani nuk ka ndodhur.

### **Pika e tretë (3) - Propozim për shqyrtimin e Buxhetit të Planifikuar të Komunës për vitin 2021.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës:** E kemi për shqyrtim, analizim dhe miratim 'Propozimin për Buxhetin e Planifikuar të Komunës për vitin 2021', ftoi Drejtorin e Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit që të na jap sqarime.

**Drejtori për Financa dhe Buxhet:** Përsëritet të pranishmit në mbledhje. Procesi i hartimit dhe përgatitjes së buxhetit të komunës për vitin 2021, ka filluar duke u mbështetur në Qarkoren e brendshme buxhetore Nr. 01, të cilën ua kemi shpërndarë të gjitha Drejtorive të Komunës, për të paraqitur projektet kapitale e zhvillimore të planifikuara dhe shpenzimet operative rrjedhëse, në projeksionet e buxhetit hyn edhe vlerësimet e herëshme për vitin 2022 dhe 2023, të cilat mund të ndryshojnë gjatë vitit të ardhshëm. Po ashtu, është e planifikuar edhe struktura e realizimit të hyrave vetjake për vitin 2021. Në fund të muajit qershor 2020, ne e kemi shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe e kemi miratuar në Kuvendin e Komunës, planifikimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitet 2021-2023, këtë planifikim e kemi dërguar në Ministrinë e Financave, për t'i hapur rrugë Qarkores së dytë buxhetore, pastaj i kemi mbajtur tre dëgjime buxhetore këtu në sallën e Kuvendit të Komunës. Ne mendojmë, se në projekt-buxhetin për vitin 2021 janë të përfshira kërkesat e nevojshme të paraqitura nga qytetarët nëpër Drejtoritë e Komunës, për infrastrukturë dhe projekte tjera kapitale, siç janë projektet për mirëmbajtjen e infrastrukturës, ambienteve brenda shkollave dhe ambulantave tona, projekteve për sport dhe të tjera. Për qytetarët është e rëndësishme tabela 4.2, ku hyn projektet kapitale, të cilat nëse kanë arsyeshmëri të bazuar mund të ndryshohen, brenda kufijëve buxhetorë. Granti i përgjithshëm për vitin 2021 është në shumë të mjeteve financiare prej: 3,527,425.00€, granti për arsim është në shumë të mjeteve financiare prej: 3,524,120.00€, granti për shëndetësi është në shumë të mjeteve financiare prej: 1,251,487.00€, ndërsa buxheti i përgjithshëm i komunës për vitin 2021, është në shumë të mjeteve financiare prej: 10,992,696.00€, ose shprehur në shifra është më i vogël se buxheti i vitit 2020, për shumën e mjeteve financiare prej: 1,615,671.00€. Ky zvogëlim i buxhetit është në fushën e arsimit, që na detyron neve të bëjmë ndryshime të mëdha në strukturën e buxhetit. Buxheti përbëhet nga granti qeveritarë në shumë të mjeteve financiare prej: 8,303,032.00€ dhe të hyrat vetjake në shumë të mjeteve financiare prej: 2,689,654.00€. Ne kemi kërkuar rritjen e numërit të punëtorëve nga 772, në 794 punëtorë, pra për njëzet e dy punëtorë të ri, në arsim dhe shëndetësi, por kjo nuk është pranuar nga Ministria e Financave. Për kategoritë ekonomike shumat e mjeteve financiare është si vijon: për paga dhe mëditjeve 5,096,346.00€, për mallëra dhe shërbime 1,712,670.00€, për shpenzime komunale 250,000.00€, për subvencione dhe transfere 355,000.00€ dhe për projekte kapitale dhe investive 3,578,670.00€. Realizimi i projekteve kapitale në vitin 2021, do të bëhet nga 2,334,654.00€ prej të hyrave vetjake dhe 1,244,016.00€ nga grantet qeveritare, por sfida do të jetë mbulimi i shpenzimeve operative në fushën e arsimit.

**Remzi Shala:** Përsëritet të pranishmit në mbledhje. Planifikimi i buxhetit të komunës për vitin 2021, është përgatitur nga Drejtoria e Financave dhe Buxhetit në bazë të kërkesave dhe nevojave të qytetarëve të paraqitura nëpër Drejtoritë e Komunës për investime publike dhe nevojat tjera operative të drejtorateve, ashtu siç u elaborua gjerësisht, edhe nga Drejtori për Financa dhe Buxhet,

por këtë vitë ne mendojmë, se do ta kemi një problem me zvogëlimin e buxhetit për fushën e arsimit, për arsye që dihen nga niveli qendrorë, po ashtu sfidë vitin e ardhshëm do të jetë edhe fusha e shëndetësisë, meqë pandemia Covid - 19, do të zgjatë edhe në vitin e ardhshëm. Strukturimi dhe radhitja e kërkesave për investime publike bëhet nga kërkesat e qytetarëve, unë personalisht kam marrë pjesë në dëgjimin e tretë publike, gjithsej janë mbajtur tre dëgjime publike. Buxheti dihet që është më i vogël se i vitit 2020, andaj duhet të zbatohet me kujdes dhe sipas prioriteteve për investime dhe plotësim të nevojave operative në shëndetësi dhe arsim. Për realizimin e projekteve publike në teren i kemi disa vërejtje të vogla nga qytetarët, mbikëqyrja menaxheriale dhe e komisioneve mbikëqyrëse të punimeve në teren, duhet të jetë më e madhe dhe në kohën e duhur. Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, propozojmë që buxheti i planifikuar për vitin 2021, që është gjithëpërfshirës me projekte publike për secilin vendbanim, të aprovohet dhe të realizohet vitin e ardhshëm, duke e patur parasysh edhe kohën e pandemisë në të cilën po jetojmë.

**Durim Hajra:** Ky projekt-buxhet i komunës, është po thuajse i njëjtë me Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitet 2021-2023, të miratuar në muajin qershor, këtu brenda vetëm po bëhet muhabet, asgjë nuk mirret parasysh, madje as gjendja me pandeminë Covid - 19, e cila përveç aspektit shëndetësorë, do të ketë pasoja të mëdha ekonomike vitin e ardhshëm. Buxheti i komunës është një shabllon që nga përfundimi i luftës, pa ndonjë ndryshim substancial, projektet kapitale dhe pjesët tjera të buxhetit, janë kopjim i njëjtë me vitet paraprake. Ne në qershor kemi kërkuar që të mirret parasysh arritja e objektivave në infrastrukturë dhe ambientë në qytet, e jo të shkohet vetëm në projekte të asfaltimit, ku asfaltimi i rrugës në muajin korrik, dëmtohet menjëherë në muajin shtator, një rastë i tillë është rruga 'Hajrullah Zymi' në Fushë-Kosovë. Unë personalisht, kam marrë pjesë në dy dëgjime buxhetore, por kërkesat tona nuk janë marrë parasysh, në dëgjimin e tretë buxhetorë kanë marrë pjesë vetëm banorët e fshatit Bardh i Madh, në njoftim thuhet se ata, kanë kërkuar rregullimin e stadiumit në fshatin e tyre dhe disa kërkesa tjera në kulturë dhe sport, ne kërkojmë që të mos manipulohet me kërkesat e qytetarëve, por mjetet financiare të orientohen në uljen e pa punësisë për rininë tonë. Kërkesat tona që janë kërkesa të dala nga takimet me qytetarët e Fushë-Kosovës, por edhe të fshatrave, të parashtruara në dy dëgjime publike dhe me shkrim në kohën e duhur nuk janë marrë parasysh fare nga Ekzekutivi i Komunës. Ne jemi të vetëdijshëm se buxheti për arsim është më i vogël për 1.2 milion euro, por shpërndarja e projekteve kapitale nuk përputhet me kërkesat e qytetarëve, vetëm ne si subjekt politikë Lëvizja Vetëvendosje, i kemi bërë tridhjetë e dy propozime, prej tyre asnjëri nuk është pranuar si i arsyeshëm nga partia politike në pushtet komunal. Kërkesat tona janë të arsyeshme dhe për plotësimin e nevojave të qytetarëve, ne kërkojmë ndërtimin edhe të një objekti të çerdhes publike, dhënien e shujtave ushqimore për nxënësit prej klasës së parë deri në të gjashtë, ndërtimin e shkollës në lagjen e Nakaradës, për të cilën mjetet financiare janë ndarë disa herë, por shkolla nuk është ndërtuar kurrë, sepse prona komunale është e uzurpuar me vite, pastaj pajisjen e shkollave tona me kabinete dhe laboratore, dixhitalizimin e tyre, nuk mund të paramendohet shkolla sot vetëm me një projektorë prapa. Ndërtimin e një qendre sociale për të moshuarit, vizita sistematike të personelit mjekësorë nëpër shkolla, kjo punë nuk kushton shumë, duhet vetëm angazhim më i

madhë, krijimin e klasëve për parashkollorë, gjetjen e zgjidhjeve për shitësit ambulantë në lagjën e Dardanisë. Vendosjen në prioritet të politikave ambientaliste për qytetin, ku ndotja është më e madhe, vendosjen e këndëve të lojërave në lagjet 028 dhe 029, krijimin e hapësirave rekreative në këto lagje, po ashtu ofrimin e mbështetjes financiare për Qendrën sociale dhe kulturore të komuniteteve. Vendosjen e këndeve të lojërave në lagjen të ndërtesat e ish/Kolonisë, në këtë lagje nuk është bërë asnjë investim nga komuna. Ndërtimin e një parku në lagjen e Xhigolëve, aty ka hapësirë për ndërtimin e një parku apo edhe një fushe sportive. Projekt shumë domethënës dhe i mirë për qytetarët, do të ishte edhe rregullimi i gypit të ujit, apo riparimi i tij, po ashtu për menaxhimin e mbeturinave duhet ta kemi një plan të veçantë, duhet të bëhet zëvendësimi i kontejnerëve mbitokësorë, me kontejnerë nëntokësorë. Ndërrimi i gypave të asbestit të rrjetit të ujësllësit nga rrethi deri tek rruga për fshatin Lismir, pastaj, krijimin e hapësirave dhe pjerrinave në rrugë për persona me nevoja të veçanta, rregullimin e hyrje/daljeve në lagjen e Dardanisë në drejtimin e hyrjes nga Prishtina, unë e di që përgjegjëja nga Drejtoria e Planifikimit Urban, do të jetë, 'jemi në proces të hartimit të planit të mobilitetit', por kjo punë po zgjatet shumë të nderuarë. Krijimin e shtegut për çiklistë në Fushë-Kosovë, renovimin e Shtëpisë së Kulturës, një qendër të trajnimit profesional për të rinjtë, kjo ka dalë si kërkesë nga takimet që ne kemi patur me përfaqësuesit e tyre. Në bujqësi ka ardhur koha që nga komuna të përkrahen sektorët e veçantë për ruajtjen e produkteve bujqësore, subvencionimin e bizneseve që udhëhiqen nga gratë, pastaj financimin e pjesëmarrjes në panairë ndërkombëtare të grave. Në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, ne kërkojmë që të diskutojmë dhe ndonjëri nga këto projekte kapitale të përfshihen në buxhet, në të kundërtën, ne nuk mund ta përkrahim aprovimin e buxhetit të komunës për vitin 2021 në këtë mënyrë, pa asnjë ndryshim substancial.

**Nënkryetari i Komunës:** Programi zgjedhor i juaji i nderuar, është ky që ju e paraqitët, kërkon veprime konkrete për realizimin e tezës tuaj. Ne i kemi ndërtuar dy çerdhe publike në fshatra tona më herët, por në mungesë të lejit të numrit të punëtorëve nga Ministria e Arsimit dhe Ministria e Financave, nuk kemi mundur t'i funksionalizojmë, sepse për një çerdhe duhen së paku gjashtë punëtorë. Në Komunën e Prishtinës janë shpërndarë kiflet, por ju e dini se kjo punë ka dështuar dhe është treguar si punë jo efektive. Shkollat tona janë të pajisuara me laboratore, ne kemi problem me numrin e madhë të nxënësve në qytet, për arsye të migrimit të popullsisë. Qendra sociale, është njësoi sikur çerdhja kërkon punëtorë. Realizimi i vizitave në shkolla mund të bëhet nga stafi i Qendrave të Mjekësisë Familjare. Hyrje/daljet nga rruga e Dardanisë në drejtim të Prishtinës i kemi analizuar për dy vjetë me Ministrinë e Infrastrukturës, por nuk po lejohen, ne shpresojmë që me 'Planin e mobilitetit' shumë çështje do t'i zgjidhim lidhur me transportin, pastaj mund të bëhet edhe shtegu për çiklistë aty ku ka mundësi. Ju duhet ta dini, se ne i realizojmë projektet kapitale që mund të funksionojnë, pas një studimi, qyteti ynë tani është në proces të ndërtimit, andaj projektet funksionale kërkojnë që të kalon edhe një kohë e caktuar.

**Aida Alimi:** Në këtë projekt-buxhet të komunës për vitin 2021, nuk vërehet ndonjë ndryshim i madh, është i njëjtë me buxhetet e viteve të kaluara. Ne nuk i kemi programet e investimeve publike nga drejtoritë përkatëse të komunës, nuk e dimë cilat rrugë të komunës do të asfaltohen,

nuk ka asnjë projekt inovativë që meriton të përmendet, andaj ne nuk mund ta votojmë një projekt-buxhet të tillë të komunës për një vitë.

**Driton Ademi:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë i kam shqyrtuar dhe analizuar me vëmendje, instrumentet e nevojshme që duhet të përmbanë një buxhet komunal, për orientimin e shpenzimeve publike. Vërejtjet e mia për strukturën e buxhetit unë i kam paraqitur edhe në muajin qershor, lidhur me menaxhimin dhe harmonizimin e nevojave të qytetarëve për Drejtoritë e caktuara të Komunës. Disa shpenzime operative nuk kanë të bëjnë me politikën e komunës dhe partisë në pushtet, investimet nuk duhet të jenë politike, por në bazë të nevojave publike dhe konsultimeve me qytetarë, ju këtë punë nuk e bëni, sepse nuk i zgjedhni përfaqësuesit e fshatrave, që është obligim ligjor për secilën komunë. Ndarja e buxhetit është 80% nga grantet qeveritare, andaj për deri sa ku buxhet që shumica e tij nuk është vetjakë, ku nuk ndryshon subvencionimi në bujqësi, nuk punohet për rregullimin e turizmit, arsimin, shëndetësisë dhe ambientit, por vazhdohet me projekte publike të njëjta, pa ndryshime të domosdoshme në orientimin e buxhetit, unë si përfaqësues i subjektit politikë Nisma Socialdemokrate dhe politikave sociale, jam kundër aprovimit të këtij buxheti për vitin 2021.

**Mehdi Lahu:** Të gjithë ne e dimë se, është punë e Ekzekutivit të Komunës planifikimi i buxhetit për vitin 2021, ne si asambleistë duhet të japim kontributin tonë për pasurimin e tij, me projekte konkrete. Unë e kam një propozim konkret, që komuna jonë të planifikon ndërtimin e fushave të tenisit, ta gjenë një lokacion, ne jemi të gatshëm të kontaktojmë me njerëzit vullnet mirë, që e dëshirojnë zhvillimin e këtij sporti në komunën tonë ta ofrojmë ndihmën tonë. Ne mendojmë, se kjo hapësirë ekziston në lokacionin te pishat, në fshatin Sllatinë e Vogël, andaj kërkojmë që ky projekt për sportin të përkrahet.

Pasi që diskutime tjera nuk pati, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim për aprovim 'Propozimin për Buxhetin e Planifikuar të Komunës për vitin 2021'.

U votua me: dymbëdhjetë vota 'për', katër 'kundër' dhe dy abstenime, gjithsej tetëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave e aprovoi 'Propozimin për Buxhetin e Planifikuar të Komunës për vitin 2021' dhe mori:

#### V E N D I M

1. Për aprovimin e Buxhetit të Planifikuar të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2021, në shumë të përgjithshme prej 10,992,686.00€, i shpërndarë nëpër programe e nënprograme të kategorive ekonomike si vijon:
  - 1.1 Për paga dhe mëditje për 772 të punësuar në Administratën Komunale, Arsim dhe Shëndetësi, buxheti i komunës është në shumë prej: 5,096,346.00€;
  - 1.2 Për mallra dhe shërbime, buxheti i komunës është në shumë prej: 1,712,671.00€;
  - 1.3 Për shpenzime komunali, buxheti i komunës është në shumë prej: 250,000.00€;
  - 1.4 Për subvencione e transfere, buxheti i komunës është në shumë prej: 355,000.00€;
  - 1.5 Për shpenzime në projekte kapitale, buxheti i komunës është në shumë prej: 3,578,670.00€.
2. Vlerësimet e hershme të caktuara me kufijtë për Buxhetin e Planifikuar me Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitin fiskal 2022, është në shumë të përgjithshme prej:

12,375,394.00€, me shumën e caktuar për projekte kapitale prej: 4,844,717.00€ dhe për vitin fiskal 2023, është në shumë të përgjithshme prej: 12,712,098.00€, me shumën e caktuar për projekte kapitale prej: 5,156,055.00€.

#### **Pika e katërt (4) - Raporti i Auditimit të Jashtëm për vitin 2019.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës:** E kemi për shqyrtim dhe analizim 'Raportin e Auditimit të Jashtëm për vitin 2019', për të cilin opinion është i pa kualifikuar, po ashtu ju të gjithë në materiale i keni, edhe komentet e menaxhmentit dhe zotimet e Ekzekutivit të Komunës për përmbushjen e rekomandimeve.

**Nënkryetari i Komunës:** Auditimi i pasqyrave financiare bëhet në bazë të standardeve dhe rregullave të caktuara paraprakisht, nga raporti i auditimit të jashtëm rezulton konstatimi, se Komuna e Fushë-Kosovës e ka shpenzuar buxhetin në bazë të rregullave dhe procedurave financiare, sipas standardeve për raportimin e pasqyrave financiare, opinion është pozitivë, por me theksim të çështjeve që duhet të adresohen nga Ekzekutivi i Komunës. Ju po e shihni edhe vetë se nga Kuvendi i Kosovës, është duke u lejuar të bëhen keqë-klasifikime, që nënkupton shpenzimin e buxhetit në programe ekonomike dhe kode ekonomike jo adekuate, nga projektet kapitale në mallëra dhe shërbime, nga të cilat po bëhet ekzekutimi i detyrueshëm i mjeteve financiare nga përmbaruesit privat, ata i marrin paratë publike nga secili kodë ekonomikë. Gabime në materialin e prezantimit të pasqyrave financiare nuk ka, ka gjetje të cilat shndërrohen në rekomandime, janë gjithsej dymbëdhjetë rekomandime, prej tyre shtatë janë zbatuar dhe pesë janë në proces të zbatimit. Secila Organizatë Buxhetore duhet ta përgatitë 'Planin për zbatimin e rekomandimeve', për Zyrën Kombëtare të Auditimit, ne këtë e kemi bërë dhe rekomandimet e pa zbatuara, do të analizohen dhe zbatohen.

**Driton Ademi:** Faktikisht në çështjen e auditimit, ne si Legjislative i Komunës dhe Ekzekutivi i Komunës ndahemi, këtu në aspektin menaxherial shprehja opinion i pa modifikuar nuk mjafton, sepse diçka këtu nuk ofrohet, meqë kjo punë rrjedhë vetëm nga mostrat e marra për shqyrtim nga auditimi i jashtëm, përjashtohen rastet tjera, por edhe nga kjo ka mjaft raste, që neve duhet të na shqetësojnë për mënyrën e shpenzimit të buxhetit komunal. Ju këtë po e merrni si vetëkënaqësi, por në vërejtjet për menaxhmentin këtu nuk hynë, ndarjet e mjeteve financiare për persona privat, subvencionet, kontratat. Sfidë ka edhe në vonesën e pagesave për obligimet kontigjente, ku rastet me vetëdije orientohen te përmbaruesit privat. Plani i veprimtimit është krejtë teknikë për sektorët e caktuar, përshkrimi i auditorit është profesional dhe i mundshëm, por nuk evidenton shumicën e shkeljeve që bëhen, në bazë të mostrave të këqija dalin këto rezultate, jo në bazë të mostrave të mira dhe të rregullta në aspektin procedural dhe material. Sugjerimi im është që me theksimin e çështjeve të merreni seriozishtë.

**Aida Alimi:** Ajo që është specifike, janë pesë gjetjet, që paraqesin në realitet pesë rekomandime, që po përsëriten dhe nuk po adresohen nga Ekzekutivi i Komunës. Këto punë dhe problem ne i kemi ngritur edhe në Kuvendin e Komunës, por nuk jemi marrë parasysh nga Ekzekutivi i Komunës. Inspektorati në komunën tonë po thuhet se nuk funksionon fare, andaj vijnë gjetjet dhe punët e dobëta, mungon mënyra e inspektimeve të punëve publike dhe punëve tjera në teren.

**Nënkryetari i Komunës:** Auditimi bëhet nga njerëzit profesionistë, ne këtyre të gjeturave ju besojmë dhe punojmë që t'i përmbushim rekomandimet. Një pjesë e keqë-klasifikimit të shpenzimeve vjenë nga kontrata e nënshkruar me Sindikatën e Arsimit para tre viteve, për pagesën e shujtave, transportit, pagave jubilarë dhe pagave suplementare në rastë të pensionimit, pa asnjë mbulesë financiare, kjo punë i ka vënë komunat tona në vështirësi të mëdha financiare. Rekomandimin për regjistrimin e pasurisë që e kemi patur para disa viteve e kemi zgjidhur. Opinioni pozitivë për komunën në punën për pasqyrat financiare në bazë të standardeve, i mundëson komunës që të marrë kredi për realizimin e projekteve publike.

**Aida Alimi:** Pyes, a keni filluar ta zbatoni Rregulloren e Ministrisë së Financave, për ndarjen e mjeteve financiare për Organizatat Jo Qeveritare?

**Mehdi Lahu:** Unë do të ndalem të çështja B3, ku qëllimshëm është vonuar zbatimi i kontratave, madje vonesa ka patur deri në gjashtë muaj, nuk është ndaluar sigurimi i kontratës, kjo punë ka ndikuar në kualitetin e punimeve, pyes pse nuk është kërkuar sigurimi?

**Nënkryetari i Komunës:** Raporti i auditimit për Organizatën Buxhetore, synon eliminimin e të gjeturave dhe kryerjen e punëve në të ardhmen konform rregullave. Ndarjen e shpenzimeve për Organizatat Jo Qeveritare, e kemi zbatuar këtë vitë dhe nuk do ta kemi më si rekomandim.

**Mirvete Gërguri:** Përsëritet të pranishmit në mbledhje. Unë do të ndalem të pjesa e prokurimit, pikat shtatë, tetë dhe nëntë, garancioni për ekzekutimin e kontratës nuk po praktikohet. Punët publike po pranohen nga një Komision mbikëqyrës prej tre anëtarëve, kjo punë nuk është në rregull. Duke filluar nga kërkesa e njësisë duhet të detajizohen objektivat, që duhet të arrihen me një kontratë publike, të caktohet menaxheri i kontratës, aty ndërhyjnë edhe zyra e prokurimit, që të sigurohet garancioni për ekzekutimin e kontratës. Tjetër te ne po dalin shumë probleme me menaxhimin e kontratës, pranohen punët publike ende pa u kryerë, unë këtë punë dje e kam ngritur edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, ku nuk janë vendosur pusetat, për këtë punë nuk janë njoftuar as banorët e zonës, ne kemi patur shumë probleme me ujë, duhet të shikohet dosja e tenderit kur jepet, specifikimi teknik i përshkruar sipas paramasës dhe paralogarisë, të përcjelljet deri në zbatimin e tij përfundimtarë në teren, në të gjitha fazat dhe sipas standardeve të parapara për punën në fjalë, për kontratën e caktuar.

**Nënkryetari i Komunës:** Janë përmendur dy raste, ne kemi dhënë arsyetimet tona dhe Zyra Kombëtare e Auditimit i ka pranuar ato, dokumentacioni është në Drejtorinë e Planifikimit Urban. Për punët e realizuara këtë vitë, duhet ta dini që jemi duke punuar në kohën e pandemisë, por problemet e ngritura tani do të shqyrtohen dhe eliminohen në teren.

**Pika e pestë (5) - Raporti i Drejtorisë së Shëndetësisë për menaxhimin e pandemisë Covid - 19, me të dhëna statistikore të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës:** E kemi për shqyrtim dhe analizim 'Raportin e Drejtorisë së Shëndetësisë për menaxhimin e pandemisë Covid - 19, me të dhëna statistikore të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë', ftoi Zyrtarin për Mirëqenie Sociale nga Drejtoria për Shëndetësi, që të na jap sqarime.

**Hysen Sllamniku - Zyrtar për Mirëqenie Sociale:** Përsëritës të pranishmit në mbledhje. Pandemia Covid - 19 si sëmundje ngjitëse dhe infektive në vendin tonë, është paraqitur në muajin mars 2020, që nga fillimi i pandemisë Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale ka filluar punën aktive, për të ndihmuar Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë, është bërë riorganizimi i hapësirave të veçanta për trajtimin e pacientëve të infektuar. Është bërë furnizimi me masa mbrojtëse për personelin mjekësorë, kontribut të madh në fillim ka dhënë edhe Kuvendi i Komunës, me vendimin për lejimin e mjeteve financiare shtesë për shëndetësinë, ky fakt ka ndikuar në menaxhimin e mirë të pandemisë. Në shëndetësinë tonë parësorë kanë punuar edhe pesë punëtorë shëndetësorë vullnetarë, por kontribut të madh kanë dhënë punëtorët shëndetësorë të projektit të Karitasit. Shënimet të zgjeruara dhe elaboruara i keni në materialin tuaj, por deri tani kanë qenë: 618 pacientë të infektuar, 437 pacientë janë të shëruar, 165 raste janë aktive dhe 16 persona kanë ndërruar jetë. Janë infektuar edhe 12 punëtorë shëndetësorë, të cilët pas shërimit janë kthyerë në punë, ndërsa 38 persona nga punëtorët shëndetësorë kanë shkuar në vetëizolim, në periudha të ndryshme nga fillimi i pandemisë. Ne kërkojmë nga Kuvendi i Komunës, që të vendos dhe gjenë një zgjidhje adekuate për pagesën e punëtorëve shëndetësorë të Karitasit, që të i'u ndahen mjete financiare shtesë, sepse ata janë profesionistë shëndetësorë dhe për punën e njëjtë paguhën për gjysmë më pak, ndërsa kontributi i tyre është i barabartë.

**Remzi Shala:** Raportin për pandeminë Covid - 19 e ndëgjua nga parafoësi im, materiali është shumë voluminoz dhe përmbanë të dhëna dhe statistika të sakta për punën e bërë. Unë si udhëheqës i sektorit të shëndetësisë në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, do të flas tani për një theksim të specifikave në komunën tonë që kanë shumë rëndësi për opinionin publik që pak janë të njohura, por këto fakte e orientojnë punën tonë, problemi është numri i madh i banorëve për të cilët ne ofrojmë shërbime shëndetësore, migrimi i popullsisë dhe pozita e Qendrës tonë shëndetësore në rrugën kryesore, shërbimet e mira shëndetësore për pacientët. Ne kemi shumë probleme, sepse nuk po na lejohet rritja e numrit të mjekëve dhe infermierëve nga Ministria e Financave. Ballafaqimi jonë me pandeminë është një e mirë, përkundër vështirësive nga kjo e keqe për njerëzimin, sepse po vendos në pah përvojën tonë të ballafaqimit me këtë sëmundje ngjitëse që e ka përfshirë gjithë botën dhe vendin tonë. Në fillim ne i kemi patur disa pajisje shëndetësore, shumë të nevojshme si masa mbrojtëse për personelin mjekësorë, që na u kanë gjetur shumë, ne pajtohemi se në fillim ka patur vështirësi dhe të panjohura, por në një periudhë shumë të shpejtë jemi organizuar, na kanë ardhur edhe furnizime dhe pajisje shëndetësore nga Ministria e Shëndetësisë dhe Komuna. Pandemia në muajin prill dhe maj, është menaxhuar mirë, pas rasteve të para në mars, në fund të muajit maj janë paraqitur edhe rastet e reja, gjatë verës pas hapjes së lejuar nga Qeveria e Kosovës kemi patur shtim të rasteve, por ato janë trajtuar në mënyrën e duhur sa i përket kujdesit parësorë shëndetësorë, ne u kemi ofruar kujdesin paranteral shëndetësorë, tre persona që kanë patur komplikime shëndetësore i kemi transportuar në Qendrën Klunike Universitare, ndërsa personat tjerë të dyshuar për infektim kanë shkuar në vetëizolim. Na ka ndihmuar edhe Ministria e Shëndetësisë me dërgimin e pesë mjekëve vullnetarë. Me angazhimin e të gjithëve: Këshillit drejtues të shëndetësisë primare, komunës, ministrisë, ne i'a kemi dalur ta

menaxhojmë situatën pandemike, e cila pritet të zgjatë edhe gjatë vitit të ardhshëm, andaj nevojitet përkrahje shtesë për sektorin e shëndetësisë, ndihmë për popullsinë e cenuar dhe me gjendje të rëndë ekonomike dhe sociale në pako ushqimore dhe pako hixhenike dhe sanitare.

**Durim Hajra:** Ne e kemi kërkuar që në rendin e ditës ta kemi raportin financiar për buxhetin e shpenzuar për menaxhimin e pandemisë, atë nuk e kemi, por edhe ky raporti narrativ dhe përshkrues i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale është i mirë se ardhur. Ne në Kuvendin e Komunës e kemi votuar për shpenzim dhe menaxhimin e pandemisë shumë prej: 404,000.00€ dhe shumë tjetër prej: 700,000.00€ për shëndetësinë dhe ekonominë, që gjithsej arrijnë shumë prej: 1.1 milion euro, andaj kërkojmë raport financiar për shpenzimin e këtyre mjeteve financiare. Është fatëkeqësi që ne si organi më i lartë i komunës duhet të bëjmë presion për dorëzimin e raportit financiarë, ne me vullnetin më të madh e kemi miratuar shumë për menaxhimin e pandemisë dhe mjetet financiare për ndihmën e qytetarëve në nevojë dhe bizneseve të komunës. Pse fshihen këto shpenzime, a ka keqëmenaxhim, apo keqpërdorim të mjeteve financiare, pa keqëkuptime kur nuk ka raportim ne si opozitë dyshojmë në shpenzimin e drejtë dhe adekuatë të këtyre mjeteve financiare. Ne e falënderojmë personelin shëndetësorë për kontributin e dhënë, ata në këtë periudhë kohore kanë patur shumë sfida dhe vështirësi, në ballafaqimin me pandeminë dhe personat e infektuar. Raporti i tyre është gjithëpërfshirës dhe me statistika të sakta, për rastet e trajtuara dhe punën e personelit shëndetësorë në kuadër të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë.

**Nënkrytari i Komunës:** Deri dhe me datën 27.09.2020, janë gjithsej 680 raste të infektuara me Covid - 19, përfaqësuesi i shëndetësisë i dha statistikat për rastet në momentin e hartimit të këtij raporti për menaxhimin e pandemisë. Raportin financiarë për shpenzimet do ta keni në mbledhjen e ardhshme.

**Aida Alimi:** Unë e dëgjova doktorin, por nga sqarimet e dhëna mund të konstatojmë se këtu nuk ka patur pandemi fare, të gjitha punët në përgjithësi janë zhvilluar. Ne e falënderojmë personelin mjekësorë për kontributin e dhënë në menaxhimin e pandemisë, në territorin e komunës tonë dhe për mjekët dhe infermerët kemi fjalë miradie. Përfaqësuesit e komunës nuk u përgjigjen të infektuarëve në muajin qershor, korrik, gusht dhe shtator pas hapjes, kjo nuk është në rregull, puna e Shtabit Emërgjent të Komunës nuk vërehet, kjo është një pa përgjegjësi e madhe, ne e shohim për ditë angazhimin në komunat tjera, duke filluar nga Kryetarët e Komunave dhe anëtarët e shtabeve emërgjente.

**Remzi Shala:** Unë folë për menaxhimin e mirë të pandemisë, ne nuk mund t'i ndalim vdekjet, detyrë e jona është trajtimi i duhur i pacientëve, sa i përket kujdesit parësorë shëndetësorë, ne nuk mund të kryejmë punët e shërbimit dytësorë dhe tretësorë shëndetësorë, sepse atë kompetencë nuk e kemi.

**Ali Ismaili:** Unë pajtohem me konstatimin tuaj i nderuari doktor sa i përket punës së mjekëve, por një kohë në Qendrën shëndetësore nuk ka mundur të bëhet as hemogrami, një analizë e thjeshtë e gjakut, pacientët po kanë vështirësi, kur nuk funksionon laboratorin, ata duhet të orientohen në laboratore private.

**Remzi Shala:** Laboratori nuk ka funksionuar dy ditë, në atë kohë, tri herë ka qenë mirëmbajtësi për rregullimin e tij, kjo punë tani është rregulluar dhe analizat kryhen për pacientët.

**Driton Ademi:** Në Qendrën shëndetësore në vazhdimësi ka probleme, por kjo nuk është tema bazë, ne e kemi raportin e shëndetësisë, por ne e kemi kërkuar raportin e rregulltë mujor të Shtabit Emërgjentë Komunal për menaxhimin e pandemisë Covid - 19. Ne nuk e kontestojmë punën dhe kontributin e personelit shëndetësorë, atë e vlerësojmë si punë të mirë dhe pozitive në menaxhimin e situatës me pandeminë dhe trajtimin e pacientëve të infektuar. Ne kërkojmë një raportim financiarë në aspektin juridikë, kërkojmë analizimin e pasqyrave financiare, nëse diçka nuk funksionon Ekzekutivi i Komunës e ka edhe Njësinë e auditimit të brendshëm, për ta audituar, vlerësuar situatën dhe për të dhënë rekomandime për përmirësim, aty ky nuk funksionon puna si duhet.

**Sabri Rexhepi:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë e mora fjalën në këtë pikë për shëndetësinë, për t'iu njoftuar se kam qenë i prekur më sëmundjen ngjitëse Covid - 19 dhe askush përveç Kryetarit të Komunës, Nënkrutarit të Komunës dhe Shefit të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, nuk e ka parë të arsyeshme të më thërret, pasi e kam bërë strishon nga Instituti Kombëtarë i Shëndetit Publik dhe kam rezultuar pozitiv, menjëherë e kam lajmëruar shefin tim dhe zëdhënësin e komunës, doktoresha Fitnete Simnica më ka thirrur katër herë, ndërsa nga komuna jo, as ju znj. Kryesuese e Kuvendit të Komunës, unë jam për pesë mandate anëtarë i Kuvendit të Komunës, kam shpërndarë ndihma nëpër familjet e varfëra në vitet e nëntëdhjeta, kam dhënë gjakë 92 herë, nuk e di pse, por kjo punë nuk është në rregull nga ana juaj. Unë kam votuar për ndarjen e 404,000.00€ për menaxhimin e pandemisë, tani pasi kam qenë edhe i infektuar, kam edhe dyshime për shpenzimin e këtyre mjeteve financiare, por ju lus të gjithëve që të mos e neglizhoni këtë sëmundje, sepse ishte sëmundje e vështirë. Nga kolegët e mi i falënderoi shumë Driton Ademin, Ali Zogjanin, Sabitin dhe Durimin të cilët më kanë dëshiruar sukses në shërim.

**Mehdi Lahu:** Ne kemi kërkuar ta kemi në shqyrtim raportin financiar, unë e falënderoi doktor Remin për sqarimet që na dha, por ne kërkojmë të kemi informata nga puna e Shtabit Emërgjentë, ku janë përfaqësuesit e komunës, policia, inspektorët. Shtabi Emërgjentë në Komunën e Prishtinës, kujdeset për rastet e infektuara, sepse personat e infektuar kanë nevojë për ndihmë, për bukë dhe gjëra tjera ushqimore dhe higjienike, pasi nuk mund të dalin, komuna duhet të kujdeset për ta.

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës:** Unë e kam patur vetë prindin tim të infektuar me Covid - 19, ai është kontaktuar dhe vizituar nga personeli mjekësorë i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë. Tani i nderuari anëtarë i Kuvendit të Komunës z. Sabri Rexhepi, ju nuk më keni njoftuar mua fare si Kryesuese e Kuvendit për daljen tuaj pozitiv me Covid - 19.

**Remzi Shala:** Ne i kemi listat e pacientëve pozitiv, listat kur ata dalin negativ dhe shërohen, listën e personave në vetëizolim dhe në bazë të këtyre listave, personeli shëndetësorë kujdeset për këta persona. Secili e ka kartelën shëndetësore, janë dy mjekë që kujdesën për procesin znj. Fitnete Simnica dhe z. Mustafë Gashi, ua përshkruajnë pacientëve terapinë paranterale.

**Ali Ismaili:** Unë pajtohem me mendimin e Nënkrutarit të Komunës, se këtu e kemi vetëm një raport për pandeminë nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, por na mungon raporti

financiarë për shpenzime shtesë që janë para të ndara nga buxheti i komunës, andaj ne kërkojmë që ta formojmë një Komision për mbikëqyrjen e shpenzimit të këtyre mjeteve financiare.

**Nënkryetari i Komunës:** Unë ju sugjeroi që kur ta shqyrtojmë raportin financiarë të shpenzimeve, të kërkonim llogari për mjetet e shpenzuara.

**Pika e gjashtë (6) - Shqyrtimi i dytë i 'Projekt-Rregullores për organizimin e punës së shkollave fillore të mesme të ulëta dhe shkollave të mesme të larta në Fushë-Kosovë.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës:** E kemi në shqyrtimin e dytë për miratim 'Projekt-Rregullores për organizimin e punës së shkollave fillore të mesme të ulëta dhe shkollave të mesme të larta në Fushë-Kosovë.

**Drejtori për Arsim:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ju e keni shqyrtuar këtë 'Projekt-Rregullores për organizimin e punës së shkollave fillore të mesme të ulëta dhe shkollave të mesme të larta në Fushë-Kosovë', e cila nuk ka ndryshime të mëdha, e kemi inkorporuar në verzionin përfundimtarë vetëm personin përgjegjës që e kemi në paralelet e ndara të shkollave tona, që ka qenë sugjerim i doktor Remit, si dhe sanksionet që duhet të shqiptohen për masat disiplinore, andaj ju ftoi që ta miratoni këtë rregullore me këto ndryshime.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim për miratim 'Projekt-Rregullores për organizimin e punës së shkollave fillore të mesme të ulëta dhe shkollave të mesme të larta në Fushë-Kosovë'.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me unanimitet të votave e miraton:

'Rregulloren për organizimin e punës së shkollave fillore të mesme të ulëta dhe shkollave të mesme të larta në Fushë-Kosovë'.

**Pika e shtatë (7) - Propozim për fillimin e procedurave për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës:** E kemi për shqyrtim 'Propozim për fillimin e procedurave për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal', të cilit i është bashkëngjitur edhe programi i punës për secilin sektorë. Ftoi Nënkryetarin e Komunës që të na jap sqarime.

**Nënkryetari i Komunës:** Lidhur me Planin Zhvillimor Komunal është kërkuar që të paraqitet programi i punës, për hartimin e këtij dokumenti strategjik, të cilin e keni të bashkëngjitur në materialin e juaj. Kuvendi i Komunës duhet ta marrë një vendim për fillimin e procedurave për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim për aprovim 'Propozimin për fillimin e procedurave për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal'

U votua me: pesëmbëdhjetë vota 'për', asnjë 'kundër' dhe pesë abstenime, gjithsej njëzet anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave e aprovoi 'Propozimin për fillimin e procedurave për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal' dhe mori:

## V E N D I M

Për aprovimin e 'Propozimit për fillimin e procedurave për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Fushë-Kosovës'.

**Pika e tetë (8) - Propozim për fillimin e procedurave për përgatitjen e Raportit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Planin Zhvillimor Komunal.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës:** E kemi për shqyrtim 'Propozim për fillimin e procedurave për përgatitjen e Raportit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Planin Zhvillimor Komunal', ftoi Nënkrjetarin e Komunës që të na jap sqarime.

**Nënkrjetari i Komunës:** Për Planin Zhvillimor Komunal të Komunës së Fushë-Kosovës, nevojitet ta kemi edhe Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor, meqë kjo kërkohet me ligj kur përgatiten plane strategjike.

Pasi që diskutime tjera nuk pati, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim për aprovim 'Propozimin për fillimin e procedurave për përgatitjen e Raportit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Planin Zhvillimor Komunal'.

U votua me: pesëmbëdhjetë vota 'për', asnjë 'kundër' dhe tre abstenime, gjithsej tetëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave e aprovoi 'Propozimin për fillimin e procedurave për përgatitjen e Raportit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Planin Zhvillimor Komunal' dhe mori:

## V E N D I M

Për aprovimin e 'Propozimit për fillimin e procedurës për përgatitjen e Raportit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Planin Zhvillimor Komunal të Komunës së Fushë-Kosovës'.

**Pika e nëntë (9) - Propozim për rishqyrtimin dhe ndryshimin e vendimit Nr. 47, të datës 02.03.2020, për shpalljen e lokalitetit të Boshtres 'Forysthia europiane' monument i mbrojtur i natyrës në fshatin Harilaç.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës:** E kemi për shqyrtim 'Propozim për rishqyrtimin dhe ndryshimin e vendimit Nr. 47, të datës 02.03.2020, për shpalljen e lokalitetit të Boshtres 'Forysthia europiane' monument i mbrojtur i natyrës në fshatin Harilaç', ashtu siç e keni në propozim-vendim. Hap diskutimin.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim për aprovim 'Propozimin për rishqyrtimin dhe ndryshimin e vendimit Nr. 47, të datës 02.03.2020, për shpalljen e lokalitetit të Boshtres 'Forysthia europiane' monument i mbrojtur i natyrës në fshatin Harilaç'.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej tetëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me unanimitet të votave e aprovoi 'Propozimin për rishqyrtimin dhe ndryshimin e vendimit Nr. 47, të datës 02.03.2020, për shpalljen e lokalitetit të Boshtres 'Forysthia europiane' monument i mbrojtur i natyrës në fshatin Harilaç' dhe mori:

## V E N D I M

Për shpalljen e lokalitetit Boshtres 'Forysthia Europea' në zonën e Goleshit në fshatin Harilaç në kategorinë monument i mbrojtur i natyrës.

**Pika e dhjetë (10) - Propozim për shqyrtimin e raportit të vlerësimit Nr. 020-593/3, të datës 28.02.2020 i vendimit për ndërtimin e Palestrës së Sporteve në zonën turistike, në Ngatrën Kadastrale P-00443-1 në fshatin Sllatinë e Vogël.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës:** Propozim për shqyrtimin e raportit të vlerësimit Nr. 020-593/3, të datës 28.02.2020 i vendimit për ndërtimin e Palestrës së Sporteve në zonën turistike, në Ngatrën Kadastrale P-00443-1 në fshatin Sllatinë e Vogël, në lokacionin te pishat, sipas Hartës Zonale të Komunës, kjo zonë është e definuar si zonë rekreative dhe turistike. Ftoi Nënkyetarin e Komunës që të na jap sqarime.

**Nënkyetari i Komunës:** Palestra e Sporteve është donacion i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ne ua kemi dërguar këtë vendim për arsye të transparencës, sepse lokacion tjetër për ndërtimin e Palestrës së Sporteve nuk kemi, andaj mbetet ne fuqi vendimi i marrë në mbledhjen e kaluar.

**Pika e njëmbëdhjetë (11) - Informatë për fillimin e vitit të ri shkollor 2020-2021.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës:** E kemi për analizim ‘Informatën e Drejtorisë së Arsimit për fillimin e vitit të ri shkollor 2020-2021’, ftoi Drejtorin e Arsimit që të na jap sqarime.

**Drejtori për Arsim:** Viti i ri shkollor 2020-2021, ka filluar me datën 14 shtator, duke i përfillur rekomandimet e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik, ne jemi befasuar me fillimin e vitit shkollorë, ku prindërit kanë qenë shumë të interesuar t’i dërgojnë fëmijet e tyre në shkollë. Mësimi po zhvillohet me rregull, klasët janë ndarë në dy grupe në qytet nga 22 nxënës. Në Çerdhën e Fëmijëve ‘Gëzimi Ynë’, i kemi patur pesë punëtorë pozitiv me Covid - 19, atje puna do të fillon me datën 1 tetor. Deri tani janë testuar 157 punëtorë të arsimit, pozitiv kanë dalur 5 punëtorë në çerdhe, 3 në shkollën ‘Mihal Grameno’ dhe 2 në objektin aneks të kësaj shkolle. Pozitiv ka dalë edhe një nxënës dhe është testuar e tërë klasa. Shënime dhe të dhëna më të detajizuara për gjendjen në arsim i keni në materialin e kësaj informate.

**Pika e dymbëdhjetë (12) - Të ndryshme.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës:** Unë dua të sqaroj se ju kolegu i nderuar z. Sabri Rexhepi, përveç Zyrtarit për Informim të Komunës dhe Shefit të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, është dashur të me lajmëroni edhe mua si Kryesuese e Kuvendit të Komunës, unë nuk kam qenë e njoftuar.

**Arjeta Jashari:** Përsëritës të pranishmit në mbledhje. Unë dua ta paraqes për shqyrtim kërkesën e banorëve të fshatit Miradi e Epërme, për rrënimin e objektit të Shtëpisë së Kulturës në fshatin tonë, kërkesa e banorëve është që në atë pjesë të ndërtohet këndi i lojërave për fëmijë, andaj kërkojmë nga Ekzekutivi i Komunës që të ndër merrë veprime adekuate në këtë drejtim.


**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës:** Për ta marrur Kuvendi i Komunës vendimin për rrënimin e objektit të Shtëpisë së Kulturës në fshatin Miradi e Epërme, duhet ta kemi propozimin e Drejtorisë për Planifikim Urban.

**Migjen Kolshi:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Së pari i dëshiroi shëndet anëtarit të Kuvendit të Komunës z. Sabri Rexhepi, por duhet të kemi kujdes sepse unë juve i nderuar pasi keni dalur pozitiv ju kam parë në market. Unë dua të kërkoj falje e nderuara znj. Kryesuese e Kuvendit të Komunës për vonesën time sot, për arsye familjare dhe personale.

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje. Mbledhja përfundoi në ora 12:35 minuta.**

**Procesmbajtës**

**Hasan Gjyrevci**



**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës**

**Per Vjollca Konjusha**

